

Të shtëna me armë zjarri, arrestohen tre persona në Prishtinë

LAJME



01/12/2022 09:43



Tre persona janë arrestuar në rrugën "Bill Clinton" në Prishtinë. Policia sot ka informuar se gjatë përlshjes ndërmjet të dyshuarve, njëri ka shtëna me armë zjarri, dhe si pasojë e përlshjes të gjithë të dyshuarit dhe një dëshmitar kanë pësuar lëndime të lehta trupore.

"Janë arrestuar tre të dyshuar meshkuj kosovar të cilët si pasojë e një mosmarrëveshje të më hershme rreth një borxhi janë përlshur fizikisht në mes veti. Gjatë përlshjes njëri nga të dyshuarit kishte shtëna me armë zjarri dhe si pasojë e përlshjes të gjithë të dyshuarit dhe një dëshmitar kanë pësuar lëndime të lehta trupore dhe kanë pranuar tretman mjekësor.", ka bërë të ditur Policia.

Njësitë policore kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe si prova materiale lidhur me rastin kanë sekuestruar një pistoletë me pesë fishekë dhe një gëzhjojë fisheku.

Rasti ka ndodhur të martën në mbrëmje.


Ndërkohë, me urdhër të prokurorit të dyshuarit janë liruar, ndërsa rasti do të vazhdojë në procedurë të rregullt.

Artikuj të ngjashëm



December 1, 2022

Presidenti gjerman mbërrin në Tiranë, pritët nga presidenti Begaj



December 1, 2022

Opozita kërkon dorëheqje të udhëheqëve të disa dikastereve pas rastit të...



December 1, 2022

Mbahet seanca e Apelit në çështjen Gucati e Haradinaj



December 1, 2022

Vidhen barna në depo të Ministrisë, arrestohen dy persona



December 1, 2022

Kurti emëron Nenad Rashiqin si Ministër për Komunitete dhe Kthim



December 1, 2022

Gexha shpreh ngushëllime për vrasjen e shtatzënës mbrëmë në QKUK

LAJME TË FUNDIT




Szczesny pret dënim nga FIFA për të dhe...



Presidenti gjerman mbërrin në Tiranë, pritët nga presidenti Begaj



Juventusit i hapet rruga për transferimin e Marco Asensio



Opozita kërkon dorëheqje të udhëheqëve të disa dikastereve...